

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

**PUNIME NDIHMËSE NË SHTRIM DHE
VESHJE ME PLLAKA**

Kodi: PK-B-12-25

Njësia e të nxënit të standardit të kualifikimit “Ndërtim” , K-B-II-25, Niv II i KSHK-së:

1.NjN- 02-II-0232-25 “Punime ndihmëse në shtrim dhe veshje me pllaka”

Niveli II i KSHK¹, referuar nivelit të II të KEK²

Miratoi:

MINISTRI

.....

1. Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
2. Korniza Europiane e Kualifikimeve

Certifikimi sipas Nivelit të II të KSHK-së për njësinë e të nxënit “Punime ndihmëse në shtrim dhe veshje me pllaka” me kod 02-II-0231-25 do të jepet nga IoAFP i akredituar sipas Urdhërit nr. 845, datë 03.07.2025 “Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional”.

Tiranë, 2025

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“PUNIME NDIHMËSE NË SHTRIM DHE VESHJE ME PLLAKA

PK-B-12-25

I. Profili Profesional i punëtorit ndihmës në shtrim dhe veshje me pllaka

a) Karakteristikat e punëtorit ndihmës në shtrim dhe veshje me pllaka.

Punëtori ndihmës për shtrimin dhe veshjen me pllaka do të jetë i aftë të kryejë detyra profesionale si i punësuar në kompani ndërtimi, që kryejnë punime ndihmëse në shtrim dhe veshje me pllaka.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, punëtori ndihmës në shtrim dhe veshje me pllaka duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë që lidhen me veprimtarinë profesionale në punime shtrimi dhe veshje me pllaka. Suksesi i punëtorit ndihmës të punimeve gipsi, patinime dhe lyerje është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj, sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e punonjësit ndihmës në shtrim dhe veshje me pllaka

Profesioni i punëtorit ndihmës në punime shtrimi dhe veshje me pllaka është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për kryerjen e punimeve ndihmëse në shtrim dhe veshje me pllaka. Me përmbushjen e të gjithave njësive të të nxënës të standardit të kualifikimit “Ndërtim” Niveli i II i KSHK-së, si dhe me përvojë pune, kursanti mund të kalojë në nivelet e metejshme të KSHK-së. Ky kurs i përgatit kursantet me kompetenca profesionale dhe aftësi të buta (soft skills) për të ushtruar disa veprimtari profesionale të përfshira në profesionin “Punëtor të ndërtimit të banesave” me kod 9313, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Punime ndihmëse në shtrim dhe veshje me pllaka”

Në përfundim të Kursit “Punime ndihmëse në shtrim dhe veshje me pllaka” kursantët do të jenë të aftë të:

- Ndhmojnë në organizimin e punës;
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit;
- Komunikojnë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët;
- Ndhmojnë në kryerjen e punimeve parapërgatitore;
- Ndhmojnë në kryerjen e përpunimit të materialeve të ndryshme;
- Identifikojnë materialet bazë të përdorura në shtrim dhe veshje me pllaka.
- Përshkruajnë mënyrën e përgatitjes së materialeve ngjitëse.
- Përgatisin materialet ngjitëse.
- Ndhmojnë organizimin e punës në nivelim e nënshtresave të dyshemeve
- Ndhmojnë nivelimin e nënshtresave të dyshemeve.
- Ndhmojnë në shtrimin e shtresës hidroizoluese, termoizoluese
- Ndhmojnë në shtrimin dhe veshjen e sipërfaqeve hidrosanitare;
- Ndhmojnë në shtrimin e sipërfaqeve të brendshme e të jashtme të ndërtesës;
- Ndhmojnë në shtrimin e trotuareve me pllaka;
- Zbatojnë standardet e profesionit, gjatë punimeve ndihmëse në shtrim e veshje me pllaka;

- Zbatojnë rregullat e sjelljes, komunikimit etik e profesional me klientët, kolegët dhe eprorët;
- Raportojnë për punën e kryer tek eprorët, sipas proceseve të punës dhe formateve të kërkuara;
- Respektojnë barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Punime ndihmëse në shtrim dhe veshje me pllaka”.

Pjesëmarrësit në Kursin për “Punime ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje” duhet të jenë mbi **16 vjeç** dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “ Punime ndihmëse në shtrim dhe veshje me pllaka”

176 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit “Punime ndihmëse në shtrim dhe veshje me pllaka”.

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit
1	Hyrje në profesionin e ndihmësit për shtrim dhe veshje me pllaka	MK-02-407-25	20 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori 20% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të ndihmësit në shtrim dhe veshje me pllaka. 2. Kursanti interpreton mënyra të ndryshme shtrimi dhe veshje me pllaka. 3. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.
2	Materialet bazë në shtrim dhe veshje me pllaka	MK-02-408-25	30 orë mësimore Rekomandohet: 30% Teori 60% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti identifikon materialet bazë të përdorura në shtrim dhe veshje me pllaka. 2. Kursanti përshkruan mënyrën e përgatitjes së materialeve ngjitëse. 3. Kursanti përgatit materialet ngjitëse .
3	Punime parapërgatitore për shtrim dhe veshje me pllaka	MK-02-409-25	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndihmon në punime parapërgatitore në nivelimin e nënshtresave të dysHEMEVE. 2. Kursanti ndihmon në përpunimin e materialeve. 3. Kursanti ndihmon në punime parapërgatitore për shtrim e veshje me pllaka.

4	Punime ndihmëse në nivelim nënshtresave të dysHEMEVE	MK-02-410-25	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndihmon në organizimin e punës në nivelim e nënshtresave të dysHEMEVE 2. Kursanti ndihmon në nivelimin e nënshtresave të dysHEMEVE. 3. Kursanti ndihmon në shtrimin e shtresës hidroizoluese, termoizoluese
5	Punime ndihmëse në shtrim dhe veshje me pllaka	MK-02-411-25	66 orë Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndihmon në organizimin e punës për veshjen me pllaka të ndryshme. 2. Kursanti ndihmon në shtrimin dhe veshjen e sipërfaqeve hidrosanitare. 3. Kursanti ndihmon në shtrimin e sipërfaqeve të brendshme të ndërtesës 4. Kursanti ndihmon në shtrimin e sipërfaqeve të jashtme të ndërtesës 5. Kursanti ndihmon në shtrimin e trotuareve me pllaka

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënit që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MEI.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Punime ndihmëse në shtrim dhe veshje me pllaka”

1. Moduli “Hyrje në profesionin e ndihmësit për shtrim dhe veshje me pllaka”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E NDIHMËSIT PËR SHTRIM DHE VESHJE ME PLLAKA	MK-02-407-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët të përshkruajnë veçoritë e profesionit të ndihmësit në shtrim dhe veshje me pllaka, të interpretojnë mënyra të ndryshme shtrimi dhe veshje me pllaka si dhe të përshkruajnë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori; 20% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të ndihmësit në shtrim dhe veshje me pllaka. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë detyrat dhe qëndrimet kryesore të punonjësit të ndihmësit në shtrim e veshje me pllaka; - të përshkruajë organizimin e vendit të punës në mënyrë ergonomike; - të përshkruajë mënyrat e mirëmbajtjes, pastrimit, sistemimit të veglave dhe vendit të punës; - të përshkruajë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me kolegët dhe eprorët; - të përshkruajë rëndësinë e bashkëpunimit në grup; - të shpjegojë rëndësinë e raportimit rregullisht tek eprori për detyrën e dhënë; - të përdorë informacionet mbi zhvillimet e teknologjisë Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. RN 2 Kursanti interpreton mënyra të ndryshme shtrimi dhe veshje me pllaka. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të lexojë skica, detaje dhe simbole të thjeshta me fragmente punimesh në shtrim e veshje me pllaka; - të interpretojë skica me konfiguracione të ndryshme për shtrimin me pllaka të sipërfaqeve të jashtme; -	

- të dallojë vendosjen e aksesorëve plotësues në shtrimin e dysHEMEVE;
- të interpretojë skica me mënyra të ndryshme shtrimi dysHEMEJE sipas llojit të pllakave;
- të interpretojë skica me mënyra të ndryshme veshje muri sipas llojit të ndërtimit;
- të interpretojë mënyra të ndryshme veshje me pllaka të sipërfaqeve hidrosanitare;
- të skicojë mënyra të ndryshme të vendosjes së shiritave zBUKURUES në veshje me pllaka të mureve;
- të interpretojë skica me mënyra të ndryshme shtrimi të trotuareve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.

RN 3 Kursanti përshkruajn rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të listojë pajisjet mbrojtëse (PMI) në vendin e punës;
- të përshkruajë standardet dhe rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të përshkruajë rëndësinë e rregullores së brendshme, si dhe sinjalistikën e kantierit të ndërtimit;
- të përshkruajë mënyrën e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- të shpjegojë procedurën e evakuimit në raste emergjente;
- të përshkruajë rregullat përkatëse, gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
- të sigurohet me mjetet e nevojshme për punimet në lartësi;
- të shpjegojë ndarjen e mbetjeve, sipas llojit;
- të shpjegojë mënyrën e transportimit të mbeturinave sipas llojit të ndarjes në vendin e duhur.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime shtrimi e veshje me pllaka.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'i jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit të ndihmësit në shtrim dhe veshje me pllaka, të interpretojnë mënyra të ndryshme shtrimi dhe veshje me pllaka si dhe të përshkruajnë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

-
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
 - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul si: përshkrimi i veçorive të profesionit të ndihmësit në shtrim dhe veshje me pllaka, interpretimi i mënyrave të ndryshme shtrimi dhe veshje me pllaka si dhe përshkrimi i rregullave të sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
-

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
- Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime shtrimi e veshje me pllaka
- Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Materialet bazë në shtrim dhe veshje me pllaka

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MATERIALET BAZË NË SHTRIM DHE VESHJE ME PLLAKA	MK-02-408-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për identifikimin e materialeve bazë të përdorura në shtrim dhe veshje me pllaka, mënyrën e përgatitjes së materialeve ngjitëse dhe përgatitjen e materialeve ngjitëse.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 30% Teori; 60% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulin e parë “Hyrje në profesionin e ndihmësit në punime shtrimi dhe veshje me pllaka”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti identifikon materialet bazë të përdorura në shtrim dhe veshje me pllaka . <i>Kriteret e vlerësimit:</i> – Kursanti duhet të jetë i aftë; – të identifikojë saktë llojet e pllakave dhe materialet ndihmëse; – të njohë dhe të emërtojë materialet bazë ; – të dallojë ngjitësin, fugën, primerin, hidroizolimin; distancat dhe materialet e tjera ndihmëse ; – t’i identifikojë materialet sipas pamjes dhe funksionit; – të tregojë se për çfarë shërben secili material, – të zgjedhë materialin e duhur sipas udhëzimit; – të zbatojë standardetë profesionale dhe sigurinë gjatë punës; – të respektojë rregullat e sigurisë gjatë përdorimit të materialeve (mbajtja e dorezave, shmangia e kontaktit me lëngje kimike, renditja në vend të sigurt) . <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> – Pyetje përgjigje me gojë. RN 2 Kursanti përshkruan mënyrën e përgatitjes së materialeve ngjitëse; <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë : – të përshkruajë materialet hidroizoluese , niveluese ngjitësit dhe përbërësit e tyre ; – të dallojë ngjitësin në pluhur dhe sasinë e ujit të nevojshme sipas udhëzimit ; – të përshkruajë hapat bazë të përgatitjes së materialeve ngjitëse; – të shpjegojë hedhjen e ujit në kovë, shtimin gradual të pluhurit, përzierjen me mikser ose shpatull, kohën e	

pushimit para ripërzierjes ;

- të përgatisë mjetet e duhura si kovë, mikser, shpatull
- të ruajë pastërtinë dhe organizimin e vendit të punës;
- të mbajë mjetet e pastra.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.

RN 3 Kursanti përgatit materialet ngjitëse;

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të ndihmojë në perzgjedhjen e materialeve dhe mjeteve përpara fillimit të punës ;
- të përgatisë materialet hidroizoluese dhe niveluese në kohën e përcaktuar ;
- të përgatisë materialin ngjitës brenda kohës së përcaktuar ;
- të ndjekë renditjen e saktë të hapave të përgatitjes ;
- të mos ndërpresë procesin e përzierjes dhe të mos lejojë ngjitësin të thahet para kohe;
- të përdorë mjetet në mënyrë të sigurt dhe efikase si pa humbje kohe dhe duke respektuar rregullat e sigurisë ;
- të respektojë kohën e përdorimit të materialeve ;
- të koordinohet me punonjësit e tjerë, për të siguruar që ngjitësi të jetë gati në momentin e duhur për aplikim ;
- të mbajë mjetet dhe zonën e punës të pastra për të shmangur ndërprerjet gjatë përgatitjes dhe aplikimit ;
- të zbatojë procedurat e sigurisë dhe higjienës në punë, gjatë manipulimit të materialeve ngjitëse ;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.

**Udhëzime për
zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime shtrimi e veshje me pllaka.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete për materialet bazë të përdorura në shtrim dhe veshje me pllaka .
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'i jepen detyra të përshkruajnë materialet bazë të përdorura në shtrim dhe veshje me pllaka si dhe të interpretojnë materiale të ndryshme shtrimi dhe veshje me pllaka
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive teorike e praktike që parashikohen në këtë modul si përshkrimi e materialeve të ndryshme që
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e

kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës mësimore, sipërfaqe të pastërta dhe të rrafshuara për shtrim dhe veshje me pllaka.

3. Moduli “Punime parapërgatitore për shtrim dhe veshje me pllaka”.

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME PARAPËRGATITORE PËR SHTRIM DHE VESHJE ME PLLAKA.	MK-02-409-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët të ndihmojnë në punime parapërgatitore për nivelimin e nënshtresave të dysHEMEVE ndihmojnë në përpunimin e materialeve si dhe ndihmojnë në punime parapërgatitore në shtrim e veshje me pllaka	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulin e parë “Hyrje në profesionin e ndihmësit në punime shtrimi dhe veshje me pllaka”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti ndihmon në punime parapërgatitore në nivelimin e nënshtresave të dysHEMEVE. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të lexojë detyrën e dhënë nga eprori; – të lexojë vizatime, skica e detaje të ndryshme të nivelimit e nënshtresave të dysHEMEVE; – të ndihmojë në përcaktimin e radhës së kryerjes së detyrës; – të pastrojë sipërfaqen e dyshemesë nga papastërtitë dhe dherat; – të bashkëpunojë me topografin për shënimin/piketimin e nënshtresave; – të transportojë dherat e tepërta në vendin e duhur sipas udhëzimeve – të ndihmojë në kontrollin e dyshemesë nga ujrat; – të shpërndajë bazën materiale, sipas udhëzimeve përkatëse; – të ndihmojë në përzgjedhjen e veglave e mjeteteve të nevojshme për nivelimin e nënshtresave të dysHEMEVE. – të ndihmojë në kontrollin e veglave, paisjeve e instrumentave niveluese për funksionalitetin e tyre; – të ndihmojë në identifikimin e sinjalistikës rrugore; – të pastrojë, sistemojë vendin e punës para kryerjes së punimeve; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë.	
	RN 2 Kursanti ndihmon në përpunimin e materialeve Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : – të ndihmojë në realizimin e përpunimit të materialeve të nënshtresave niveluese	

- të ndihmojë në përpunimin e fletëve të kartonit të bitumuar sipas kushtit teknik;
- të ndihmojë në teknika të ndyshme të prerjeve së pllakave të shtrimit e veshjes;
- të ndihmojë në realizimin e përpunimit të pllakave veshëse të shkallëve,davancave,pragjeve etj. sipas përmasave në skicë;
- të ndihmojë në realizimin e shpimit,zmusimit dhe prerjen me gur freksibël të pllakave;
- të sistemojë, pastrojë vendin dhe veglat e punës mbas mbarimit të detyrës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.

RN 3 Kursanti ndihmon në punime parapërgatitore në shtrim e veshje me pllaka

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të lexojë detyrën e dhënë nga eprori;
- të ndihmojë në përcaktimin e radhës së kryerjes së detyrës;
- të pastrojë sipërfaqen e dyshemesë dhe mureve nga papastërtitë
- të ndihmojë në kontrollin sipërfaqen e dyshemesë nga lagështia;
- të kryejë matje dhe shënime në objektin e ndërtimit
- të shpërndajë bazën materiale,sipas udhëzimeve përkatëse;
- të ndihmojë në përzgjedhjen e veglave e mjeteteve të nevojshme për shtrim e veshje me pllaka;
- të ndihmojë në kontrollin e veglave,paisjeve e instrumentave niveluese për funksionalitetin e tyre;
- të kryejë vendosjen e pllakave në ujë sipas udhëzimeve;
- të ndihmojë në ashpërsimin e sipërfaqeve për veshje me pllaka;
- të ndihmojë në korrigjimin e rrafshëtisë së sipërfaqeve para punimeve në veshje;
- të ndihmojë në identifikimin e sinjalistikës rrugore;
- të pastrojë, sistemojë vendin e punës para kryerjes së punimeve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.

**Udhëzime për
zbatimin e modulit**

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime shtrim dhe veshje me pllaka.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve kryesore për shtrim dhe veshje me pllaka
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Kursantët duhet të angazhohen në demonstrime për përfitimin e shkathtësive praktike për punime ndihmëse parapërgatitore në nivelimin e nënshtresave të dysHEMEVE dhe në shtrim e veshje me pllaka si dhe të ndihmojnë në përpunimin e materialeve.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul si: të ndihmojnë në punimet parapërgatitore në nivelimin e nënshtresave të dysHEMEVE dhe në shtrim e veshje me pllaka si dhe të ndihmojnë në përpunimin e materialeve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënës.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:.

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet instrumentet dhe materiale pune dhe aksesoret përkatës për punime shtrimi dhe veshje me pllaka.
 - Katalogë, skica, detaje fletë projekti rregullore, manuale, udhëzues, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Punime ndihmëse në nivelim nënshtresave të dysHEMEVE”.

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME NDIHMËSE NË NIVELIM TË NËNSHTRESAVE TË DYSHEMEVE.	MK-02-410-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për të kryer punime ndihmëse që lidhen me përgatitjen dhe nivelimin e nënshtresave të dysHEMEVE.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulin e parë “Hyrje në profesionin e ndihmësit në punime shtrimi dhe veshje me pllaka”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Kursanti ndihmon në organizimin e punës në nivelim e nënshtresave të dysHEMEVE Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të ndihmojë në planifikimin e bazës materiale, mjeteve, instrumenteve dhe pajisjeve të punës sipas proceseve të punës; – të ndihmojë në përcaktimin e radhës së kryerjes së punimeve të nënshtresave, nivelimit dhe izolimit të sipërfaqeve. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Pyetje përgjigje me shkrim.
	RN 2	Kursanti ndihmon në nivelimin e nënshtresave të dysHEMEVE. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : – të përgatisë sipërfaqen për nivelim; – të pastrojë nënshtresën e dyshemesë nga pluhuri, mbeturinat dhe pjesët e shkërmoqura ; – të sigurojë që sipërfaqja është e pastër, e thatë dhe e qëndrueshme për nivelim ; – të lage dyshemenë e pllakës së themelit sipas kushteve teknike të zbatimit; – të ndihmojë në formimin e takove dhe fashove drejtuese në sipërfaqe duke u bazuar në shënimet e kuotës; – të ndihmojë në përgatitjen, mbushjen dhe rrafshimin e nënshtresës ; – të ndihmojë në përhapjen e materialit nivelues sipas udhëzimeve ; – të ndihmojë në kryerjen e nivelimit përfundimtar të sipërfaqeve sipas kuotave të shënuara brenda kohës së

- punueshmërisë së tij;
- të përdori mjetet pa rrezik për veten ose të tjerët ;
- të respektojë afatin kohor ;
- të ndihmojë në kontrollin e rrafshësisë ;
- që nënshtresa është uniforme dhe gati për shtrimin e dyshemesë ;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve;
- të pastrojë dhe mirëmbajë mjetet e punës pas kryerjes së nënshtresave, nivelimit dhe izolimit të sipërfaqes së dyshemeve;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

RN 3 Kursanti ndihmon në shtrimin e shtresës hidroizoluese, termoizoluese.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të identifikojë materialet dhe mjetet që përdoren për shtrimin e shtresës hidroizoluese dhe termoizoluese;
- të pastrojë dhe të sigurojë që sipërfaqja është e thatë, dhe e gatshme për shtrimin e materialit hidroizolues ose termoizolues;
- të ndihmojë në përgatitjen e sipërfaqes sipas kërkesave teknike para vendosjes së shtresave izoluese;
- të zbatojë në praktikë teknikën e saktë të shtrimit të shtresës hidroizoluese;
- të ndihmojë në vendosjen në mënyrë korrekte shtresën termoizoluese, duke respektuar standardet e trashësisë dhe lidhjes ndërmjet paneleve
- të përdorë mjetet e punës në mënyrë të sigurt dhe të ndihmojë në vendosjen më efikase ;
- të respektojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes në punë gjatë gjithë procesit;
- të bashkëpunojë me pjesëtarët e grupit, duke ndjekur udhëzimet teknike;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve;
- të pastrojë dhe mirëmbajë mjetet e punës pas kryerjes së nivelimit dhe izolimit të sipërfaqeve;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në në objekt ndërtimi ose mjedise pune ku kryhen punime të shtrimit të nënshtresave , nivelimit e izolimit të sipërfaqeve.

-
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve kryesore të shtrimit të nënshtresave , nivelimit e izolimit të sipërfaqeve.
 - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
 - Kursantët duhet të angazhohen në demonstrime për përfitimin e shkathtësive praktike për shtrimin e nënshtresave ,Kopjo rn
 - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.kopjo rn
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxenit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:.
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet instrumentet dhe materiale pune dhe aksesoret përkatës për përgatitjen dhe nivelimin e nënshtresave të dyshemeve.
 - Katalogë, skica,detaje fletë projekti rregullore, manuale, udhëzuesa, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

5. Moduli “Punime ndihmëse në shtrim dhe veshje me pllaka”.

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME NDIHMËSE NË SHTRIM DHE VESHJE ME PLLAKA	MK-02-411-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për të kryer punime ndihmëse në : organizimin e vendit të punës, shtrimin dhe veshjen e sipërfaqeve hidrosanitare, shtrimin e sipërfaqeve të brendshme e të jashtme të ndërtesës dhe shtrimin e trotuareve me pllaka.	
Kohëzgjatja e modulit	66 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti ndihmon në organizimin e vendit të punës Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të marrë detyrën e dhënë nga eprori; – të ndihmojë në kontrollin e rrafshhtësisë dhe vertikalitetin e mureve me mjete matëse e niveluese; – të përdorë korrekt terminologjinë profesionale; – të ndihmojë në kontrollin e nivelimit të sipërfaqeve hidrosanitare me mjete matëse e niveluese; – të ndihmojë në kontrollin e vendosjen së piletës sipas vijës së pjerrësisë për largimin e ujrave; – të ndihmojë në kontrollin e piketave për shtrimin e pllakave të trotuarit; – të ndihmojë në organizimin vendin e punës në mënyrë ergonomike, sipas udhëzimeve; – të sistemojë, pastrojë vendin dhe veglat e punës mbas mbarimit të detyrës; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgimi me listë kontrolli. RN 2 Kursanti ndihmon në shtrimin dhe veshjen e sipërfaqeve hidrosanitare Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : – të ndihmojë në fiksimin e mastar-nivelës sipas shënimit në sipërfaqen e murit; – të përgatisë kollën me ujë sipas udhëzimeve në paketim; – të ndihmojë në veshjen e murit sipas konfiguracionit në skicë;	

- të vendosë kryqet dhe me ndihmën e specialistit shiritin zburues sipas skicës;
- të heqë mastarin për vendosjen e pllakat plotësuese;
- të ndihmojë në vendosjen e pllakave referuese në dysheme sipas skicës;
- të ndihmojë në shtrimin e dyshemesë me pllaka në mjediset sanitare sipas konfiguracionit dhe skicës;
- të vendosë kryqet në fugaturat midis pllakave;
- të ndihmojë në kontrollin e përshtatjes së shtrimit të pllakave me piletën sipas detajit;
- të ndihmojë në pastrimin e fugave dhe hedhjen e bojakut;
- të ndihmojë në prerjen e pllakave plotësuese sipas përmasave reale;
- të vendosë pllakat në vendet bosh sipas skicës në veshje dhe shtrim;
- të ndihmojë në pastrimin e fugave dhe hedhjen e bojakut të gatshëm midis tyre;
- të pastrojë nga bojaku tepërt sipërfaqen e veshur dhe shtruar me pllaka;
- të sistemojë, pastrojë vendin dhe veglat e punës mbas mbarimit të detyrës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti ndihmon në shtrimin me pllaka të sipërfaqeve të brendshme të ndërtesës

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë kollën me ujë sipas udhëzimeve në paketim;
- të shtrojë kollën për shtrimin e pllakave të rrjeshtit të parë;
- të ndihmojë në vendosjen e pllakave referuese në dysheme sipas skicës;
- të ndihmojë në shtrimin me pllaka të ambjenteve brendshme sipas konfiguracionit të dhënë;
- të ndihmojë në shtrimin me pllaka të pragjeve të dyerve, davarcaleve, parmakët e shkallëve;
- të ndihmojë në vendosjen e plintuesave të gatshëm;
- të ndihmojë në pastrimin e fugave dhe hedhjen e bojakut
- të pastrojë sipërfaqen e shtruar me pllaka nga bojaku i tepërt;
- të sistemojë, pastrojë vendin dhe veglat e punës mbas mbarimit të detyrës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.

- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN4 Kursanti ndihmon në shtrimin e sipërfaqeve të jashtme të ndërtesës me pllaka guri

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të ndihmojë në vendosjen e armaturës anësore lineare prej dërrase duke e përforcuar me tako;
- të lagë me ujë sipërfaqen që do shtrohet sipas shënimeve teknike;
- të ndihmojë në sheshimin dhe ngjeshjen(nënstruktura e çakullit me trashësi deri 30cm sipas kushteve teknike të zbatimit;
- të ndihmojë në shtrimin e ngjitësit(laç drenazhues i gatshëm paviflix)me trashësi 5cm;
- të ndihmojë në shtrimin e pllakave të gurit duke kontrolluar me mastar-nivelë;
- të ndihmojë në mbushjen midis fugave me material lidhës paviflix extra;
- të pastrojë sipërfaqen nga bojaku i tepërt;
- të sistemojë, pastrojë vendin dhe veglat e punës mbas mbarimit të detyrës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN5 Kursanti ndihmon në shtrimin e trotuareve me pllaka.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të ndihmojë në shtrimin dhe ngjeshjes me rul dore të shtresave inerte(zhavorrit,çakullit stabilizantit)duke respektuar kuotat përkatëse respektive;
- të ndihmojë në shtrimin me makineri e betonit të varfër të gatshëm deri në kuotën e caktuar;
- të ndihmojë në hedhjen e shtresës së rërës dhe shtrimin e pllakave të trotuarit;
- të ndihmojë në ngjeshjen me rul të sipërfaqes shtruar me pllaka
- të mbushë fugat midis pllakave me rërë sipas kushteve teknike;
- të pastrojë sipërfaqen e shtruar nga rëra e tepërt mbas një kohe të caktuar;
- të sistemojë, pastrojë vendin dhe veglat e punës mbas mbarimit të detyrës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime shtrimi dhe veshje me pllaka.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve kryesore për shtrim dhe veshje me pllaka.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Kursantët duhet të angazhohen në demonstrime për përfitimin e shkathtësive praktike të ndihmojnë në : organizimin e vendit të punës,shtrimin dhe veshjen e sipërfaqeve hidrosanitare, në shtrimin e sipërfaqeve të brendshme e të jashtme të ndërtesës si dhe shtrimin e trotuareve me pllaka.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul, si të ndihmojnë në : organizimin e vendit të punës,shtrimin dhe veshjen e sipërfaqeve hidrosanitare, në shtrimin e sipërfaqeve të brendshme e të jashtme të ndërtesës si dhe shtrimin e trotuareve me pllaka.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithave kritereve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet instrumentet dhe materiale pune dhe aksesoret përkatës për punime shtrim dhe veshje me pllaka.
 - Katalogë, skica,detaje fletë projekti rregullore, manuale, udhëzuesat, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul
-